



Informacion për pacientët Ndryshimet në rregullin "Public Charge"

Informacion nga data 10/18/2018

Qeveria federale mund të ndryshojë disa rregulla për personat që aplikojnë për kartat jeshile ose disa viza (quajtur "public charge" [në ngarkim të publikut]). Ky ndryshim mund ta bëjë më të vështirë marrjen e një karte jeshile ose vize për ata që përdorin disa nga ndihmat e shtetit (Shembuj: Medicaid, Food Stamps [Kuponë ushqimi]).

Ndihmat apo përfitimet që merrni sot **nuk ndikojnë** në asnjë aplikim për kartë jeshile apo vizë. E drejta për përfitime **nuk ka ndryshuar**.

NYC Health + Hospitals NUK pajtohet me këto ndryshime. Ne duam që ju të merrni kujdesin që ju nevojitet dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor të cilin keni të drejtë ta përfitoni.

Ne mirëpresim çdokënd në NYC Health + Hospitals, pavarësisht statusit tuaj të imigrimit. Ky është përkushtimi ynë dhe kjo nuk do të ndryshojë kurrë.

Nëse keni pyetje se si marrja e përfitimeve apo ndihmave nga shteti mund të ndikojë te statusi juaj i imigrimit, lini një takim pa pagesë dhe konfidencial me një avokat të LegalHealth në NYC Health + Hospitals, ose telefononi linjën e informacionit të LegalHealth në numrin 212-659-6188.